

Espresso.Insight

Nr. 02/2026

Madhësia e Qeverisë: Nevojë Funktionale apo Kalkulim Politik?

Naser Shamolli

—

Shkurt 2026



GROUP FOR LEGAL
AND POLITICAL
STUDIES

MADHËSIA E QEVERISË: NEVOJË FUNKSIONALE APO KALKULIM POLITIK?

Autor: Naser Shamolli- Hulumtues i Lartë, Grupi për Studime Juridike dhe Politike

Pothuajse çdo herë kur vjen procesi i krijimit të qeverisë, shqyrtohet numri i ministrive që do të propozohen. Vendime të tilla janë përcjellur me kritika, përfshirë edhe nga GLPS, për numrin e madh të ministrive dhe sidomos kabineteve të tyre. Rrjedhimisht, si pasojë e numrit të madh, janë ndërmarrë iniciativa ligjore por edhe politike për të kufizuar këtë numër por jo gjithëherë të njëjtat ishin efikase gjatë zbatimit në praktikë. Dilemë mbetet nëse kufizimi i numrit të ministrive duhet të bëhet me ligj apo kjo është çështje e Qeverisë.

Iniciativa e parë për kufizimin e numrit të ministrive me ligj ishte në vitin 2018, e finalizuar në vitin 2020, kur përmes një projektligji për Qeverinë ishte vendosur një maksimum i numrit të ministrive i cili ishte 15+2. Në [opinionin e Komisionit të Venecias](#) për këtë projektligj theksohet se Kushtetuta pengon Kuvendin që përmes një ligji të bëjë përcaktimin e një numri të ministrive por që rekomandon përdorimin e kriterëve objektive për të përcaktuar domosdoshmërinë për përcaktimin e numrit. Opinioni, për kalimin e kësaj pengese kushtetuese, si alternativë njeh ndryshimin e [nenit 96.2](#) të Kushtetutës. Si rezultat i këtij opinioni por edhe dilemave kushtetuese, [ligji i Qeverisë](#) i miratuar në vitin 2022 dhe që është në fuqi nuk përmban më kufizimin e numrit të ministrive.

Çështja e përcaktimit të numrit të ministrive duhet shikuar nga këndvështrimi i parimit të ndarjes së pushteteve, i përcaktuar në [nenin 4](#) të Kushtetutës. Prandaj mundësia që Qeveria të caktojë numrin e ministrive me akt të brendshëm duhet interpretuar dhe kuptuar së bashku me këtë parim dhe me sistemin e kontrolleve dhe balanceve në mes të vet pushteteve.

Thënë këtë, me rregullimin kushtetues, përcaktimi i numrit të ministrive është në diskrecion të Qeverisë. Qeveria është e autorizuar direkt nga Kushtetuta të caktojë numrin e ministrive me aktin e brendshëm, ndërsa Kuvendi përmes mekanizmave të vet mund të kufizojë Qeverinë në krijimin e ministrive dhe vet madhësinë e saj. Në këtë rast, me madhësi nuk nënkuptohet ngushtë numri i ministrive por burimet njerëzore, përfshirë kabinetet dhe shërbyesit civil.

Meqenëse autorizimi i Qeverisë për përcaktimin e numrit të ministrive është burimor dhe caktohet nga vet Kushtetuta, kjo nuk përjashton përgjegjësinë e dyfishtë që ka në raport me shpenzimin e parasë publike por edhe përgjegjësinë politike që ka ndaj Kuvendit.

Sa do që Qeveria është e "lirë" të përcaktojë numrin e ministrive, ashtu siç thekson edhe opinioni i Komisionit të Venecias, duhet ekzistuar disa kufizime përmes caktimit të disa kriterëve objektive dhe të matshme për këtë qëllim. Nga vitet e kaluara kishte praktika jo të mira dhe mësimet sa i përket numrit por edhe vet bashkimit "artificial" të disa ministrive që kanë shkaktuar mjaft dëme si në personelin e tyre por edhe përmbushjen e detyrave të tyre. Rasti tipik është ai i bashkimit të Ministrisë së Administratës Publike dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme. Edhe pse brenda sektorit të njëjtë, fushëveprimet e këtyre dy ministrive ishin të ndryshme dhe në praktikë dërguan deri te prioritizimi i pabalancuar

Në përbërjen e kabinetit të Qeverisë Kurti III, numri i ministrive është rritur nga 15 në 19. Kjo rritje përfshin rikthimin e Ministrisë së Administratës Publike, një vendim që mund të argumentohet si i nevojshëm në kontekstin e reformës së administratës publike dhe koordinimit të politikave të shërbimit civil. Megjithatë, paralelisht me këtë zhvillim, janë krijuar edhe ministri të reja pa një analizë të qartë të nevojës funksionale dhe institucionale, kryesisht përmes ndarjes së ministrive ekzistuese. Një shembull ilustrues është krijimi i Ministrisë së Sportit dhe Rinisë, e cila për më

shumë se dy dekada ka funksionuar brenda Ministrisë së Kulturës. Kjo qasje është indikacion se zgjerimi i qeverisë është më shumë rezultat i konsideratave politike sesa i nevojës reale. Kjo rritje, prodhon pasoja të drejtëpërdrejta, duke rritur buxhetin, duke krijuar nevojë për struktura të reja drejtuese, pozita shtesë menaxheriale dhe mekanizma të rinj koordinimi. Ky proces bëhet edhe më kompleks kur vie puna te riorganizimi dhe klasifikimi i vendeve të punës. Në retrospektivë, nëse vlerësojmë riorganizimin e qeverisë të vitit 2021, këto procese nuk kanë përfunduar për shumicën e institucioneve publike.

GLPS konsideron që një nga skenarët që mund të aplikohet për numrin e ministrive dhe që është më i saktë për nga pikëpamja e fushëveprimit të ministrive që do të krijohen, është ai i bazuar në sektor. Ekzistojnë disa lloje të sektorëve në bazë të cilëve mund edhe të krijoheshin ministritë të cilat janë të paraqitura si më poshtë dhe që mund të shërbejnë edhe në përcaktimin e numrin dhe llojin e ministrive:

Qendra e Qeverisë e cila nën kompetencat e saj mund të ketë Zyrën e Kryeministrit (cila ushtron funksione të koordinimit, kontrollit të politikave dhe legjislacionit si dhe monitorimit të tyre), agjenci ekzekutive të cilat themelohen për mbulimin e funksioneve të koordinimit qeveritar apo të natyrës horizontale.

Punët e Jashtme, që mund të përfshijë Ministrinë e Punëve të Jashtme

Qeverisja e Mirë, që mund të përfshijë Ministrinë e Administratës Publike dhe Ministrinë e Pushtetit Lokal.

Sundimi i Ligjit, që mund të përfshijë Ministrinë e Drejtësisë.

Mbrojtja dhe Siguria Publike, që mund të përfshijë Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme

Financat Publike, që mund të përfshijë Ministrinë e Financave.

Zhvillimi Ekonomik, që mund të përfshijë Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Industrisë.

Infrastruktura dhe Mjedis, që mund të përfshijë Ministrinë për Mjedis dhe Ministrinë e Infrastrukturës.

Arsimi, Shkenca dhe Inovacioni, që mund të përfshijë Ministrinë për Arsim, Shkencë dhe Inovacion.

Kultura, Sporti dhe Turizmi, që mund të përfshijë Ministrinë e Kulturës, Sportit dhe Turizmit

Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale që mund të përfshijë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Të gjitha ministritë ekzistuese dhe fushëveprimi i tyre që nuk janë pjesë e sektorëve më lartë mund të shkrihen pra të bëhen pjesë e ndonjë ministrie bazuar në karakteristikat tipike që i kanë sipas sektorit.

Sa i përket integritimit Evropian, duke qenë prioritet i vendit, kërkon një strukturë të centralizuar që siguron zbatimin efektiv të reformave dhe obligimeve. Është e rëndësishme që si fushëveprim të mbetet në kuadër të Zyrës së Kryeministrit apo potencialisht të krijohet si Agjenci Ekzekutive, shkaku i natyrës së funksioneve horizontale dhe të koordinimit që i ka.

Në vitet 2008 dhe 2009, ka përfunduar një proces rishikimi funksional të Qeverisë dhe ministrive, por që asnjëherë nuk janë marrë parasysh seriozisht rekomandimet e dala nga ky rishikim. Këto rekomandime janë ende të vlefshme dhe mund të aplikohet edhe sot në mënyrë që kur diskutohet për numrin dhe fushëveprimin e ministrive të ndjekin metoda të sakta dhe objektive të bazuara në evidencë.

Si përfundim, Qeveria mund të caktojë numrin e ministrive por bazuar në disa kritere objektive dhe në nevojë, si dhe duke marrë parasysh analizën funksionale dhe tiparet e fushëveprimit të secilës ministri. Qeveria mbetet përgjegjëse dhe llogaridhënëse kundrejt shpenzimit efikas të parasë publike, efektivitetit në sektore, si para Kuvendi ashtu edhe publikut.



GROUP FOR LEGAL
AND POLITICAL
STUDIES

legalpoliticalstudies.org